



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 295 , datë 10.5.2019

PËR

PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE
PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE
TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA
TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN
E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE
PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË,
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 74, dhe të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.
2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019-2020, të jetë nota 6.5 (gjashtë pikë pesë).
3. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet

të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vijim.

4. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përlogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:
 - a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;
 - b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.
5. Për kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2019-2020, nota mesatare e përlogaritur sipas këtij vendimi të jetë nota 7.5 (shtatë pikë pesë). Nota mesatare e kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë përlogaritet sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi.
6. Programet e studimit të fushës së mësuesisë përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.
8. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përlogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
9. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përlogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përlogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore

vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT

BESA SHAHINI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

KOSTANDIN SHKURTI



Shtojca 1

| Nr. | INSTIUCIONI I ARSIMIT TË LARTË | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
|-----|--|--|---------------|
| 1 | Universiteti i Tiranës | Biologji | 7.5 |
| 2 | | Filozofi | 7.5 |
| 3 | | Fizikë | 7.5 |
| 4 | | Gjeografi | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë angleze | 7.5 |
| 6 | | Gjuhë angleze (Sarandë) | 7.5 |
| 7 | | Gjuhë frënge | 7.5 |
| 8 | | Gjuhë gjermane | 7.5 |
| 9 | | Gjuhë greke | 7.5 |
| 10 | | Gjuhë italiane | 7.5 |
| 11 | | Gjuhë - Letërsi | 7.5 |
| 12 | | Gjuhë ruse | 7.5 |
| 13 | | Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe Qytetërim hispanik | 7.5 |
| 14 | | Gjuhë turke | 7.5 |
| 15 | | Histori | 7.5 |
| 16 | | Informatikë | 7.5 |
| 17 | | Kimi | 7.5 |
| 18 | | Matematikë | 7.5 |
| 19 | | Psikologji | 7.5 |
| 20 | | Sociologji | 7.5 |
| Nr. | | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" | Biologji - Kimi | 7.5 |
| 2 | | Edukim qytetar | 7.5 |
| 3 | | Filozofi - Sociologji | 7.5 |
| 4 | | Gjeografi dhe Gjuhë italiane | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë - Letërsi | 7.5 |
| 6 | | Gjuhë angleze | 7.5 |
| 7 | | Gjuhë frënge | 7.5 |
| 8 | | Gjuhë gjermane | 7.5 |
| 9 | | Gjuhë italiane | 7.5 |
| 10 | | Histori - Gjeografi | 7.5 |
| 11 | | Histori dhe Gjuhë gjermane | 7.5 |
| 12 | | Matematikë informatike | 7.5 |
| 13 | | Matematikë - Fizikë | 7.5 |

| | | | |
|------------|---|------------------------------------|--------------------------|
| 14 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7.5 |
| 15 | | Mësuesi për arsim fillor | 7.5 |
| 16 | | Psikologji | 7.5 |
| Nr. | Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Gjermanisht - Anglisht | 7.5 |
| 2 | | Gjuhë Angleze | 7.5 |
| 3 | | Gjuhë - Letërsi - Anglisht | 7.5 |
| 4 | | Histori | 7.5 |
| 5 | | Informatikë - Anglisht | 7.5 |
| 6 | | Matematikë - Informatikë | 7.5 |
| 7 | | Mësuesi për arsim fillor | 7.5 |
| 8 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7.5 |
| 9 | | Psikologji - Sociologji | 7.5 |
| Nr. | Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - Kimi | 7.5 |
| 2 | | Gjuhë - Letërsi shqipe | 7.5 |
| 3 | | Gjuhë - Letërsi angleze | 7.5 |
| 4 | | Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim grek | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë - Letërsi italiane | 7.5 |
| 6 | | Histori - Gjeografi | 7.5 |
| 7 | | Matematikë - Informatikë | 7.5 |
| 8 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 |
| 9 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 |
| 10 | Fizikë dhe teknologji informacioni | 7.5 | |
| Nr. | Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - Kimi | 7.5 |
| 2 | | Filozofi - Sociologji | 7.5 |
| 3 | | Gjuhë angleze | 7.5 |
| 4 | | Gjuhë dhe kulturë frënge | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë - Letërsi | 7.5 |
| 6 | | Histori - Gjeografi | 7.5 |
| 7 | | Matematikë - Fizikë | 7.5 |
| 8 | | Matematikë - Informatikë | 7.5 |
| 9 | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 | |

| | | | |
|------------|---|----------------------------------|----------------------|
| 10 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 |
| Nr. | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Biologji | 7.5 |
| 2 | | Fizikë | 7.5 |
| 3 | | Gjuhë angleze | 7.5 |
| 4 | | Gjuhë italiane | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 7.5 |
| 6 | | Histori - Gjeografi | 7.5 |
| 7 | | Informatikë | 7.5 |
| 8 | | Kimi | 7.5 |
| 9 | | Matematikë | 7.5 |
| 10 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 |
| 11 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 |
| 12 | Pedagogji e specializuar | 7.5 | |
| Nr. | Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| | | | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - Kimi | 7.5 |
| 2 | | Fizikë | 7.5 |
| 3 | | Gjeografi | 7.5 |
| 4 | | Gjuhë - Letërsi | 7.5 |
| 5 | | Gjuhë angleze | 7.5 |
| 6 | | Gjuhë frënge | 7.5 |
| 7 | | Gjuhë gjermane | 7.5 |
| 8 | | Gjuhë italiane | 7.5 |
| 9 | | Histori | 7.5 |
| 10 | | Informatikë | 7.5 |
| 11 | | Matematikë | 7.5 |
| 12 | | Mësuesi arsimit fillor | 7.5 |
| 13 | Mësuesi arsimit parashkollor | 7.5 | |
| 14 | Psikologji | 7.5 | |
| Nr. | Kolegji universitar "Bedër" | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| | | | NOTA MESATARE |
| 1 | | Arsimi parashkollor dhe fillor | 7.5 |
| 2 | | Gjuhë dhe letërsi angleze | 7.5 |
| 3 | Psikologji këshillimi dhe Pedagogji | 7.5 | |
| Nr. | Kolegji universitar "Wisdom" | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| | | | NOTA MESATARE |
| 1 | Psikologji | 7.5 | |

| | | | |
|------------|--|--------------------------------------|-----|
| Nr. | SHLUJ, Universiteti "Marin Barleti" | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Psikologji | 7.5 |
| Nr. | Universiteti European i Tiranës | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Psikologji | 7.5 |
| 2 | | Sociologji - Antropologji sociale | 7.5 |
| 3 | | Filozofi | 7.5 |
| 4 | | Histori | 7.5 |
| 5 | | Letërsi | 7.5 |
| 6 | | Linguistikë | 7.5 |
| 7 | | Arsim parashkollor | 7.5 |
| Nr. | Universiteti i New York-ut në Tiranë | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Psikologji | 7.5 |
| Nr. | Universiteti privat "Albanian University" | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Anglisht | 7.5 |
| 2 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 |
| 3 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 |
| 4 | | Psikologji e përgjithshme | 7.5 |
| Nr. | Kolegji universitar "Logos" | PROGRAMI I STUDIMIT | |
| 1 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 |
| 2 | | Gjuhë dhe Civilizim grek | 7.5 |

NR.PROT. 2519/1
DATË 10.5. 2019

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
UNIVERSITETEVE PUBLIKE DHE PRIVATE
DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

